

Autoriteti Kontraktor: Rrjeti i Organizatave për Zhvillim Rural të Kosovës

MBËSHTETJE PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE NËPËRMJET FONDIT TË AKADEMISË “NGA FERMA NË TRYEZË”

UDHËZIM PËR APLIKANTËT E GRANTEVE

Nr. i referencës së thirrjes: F2F Academy 2022/441-175

Afati për dorëzimin e aplikimit të plotë:

25 prill 2025 deri në orën 23:59

Shënim

Kjo është një thirrje e hapur për propozime përmes një procedure aplikimi me një fazë ku të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen nga aplikantët në të njëjtën kohë. Në radhë të parë do të vlerësohet kontrolli administrativ. Po ashtu, do të kontrollohet edhe e drejtat për të konkurruar sipas dokumenteve mbështetëse të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor. Më pas, për aplikantët që janë përzgjedhur paraprakisht, do të vlerësohen projekt propozimet.

Udhëzimet e përshkruara në këtë dokument do t'i ndihmojnë të gjithë aplikantët të dorëzojnë me sukses aplikimet e tyre. Paketën e aplikimit mund ta shkarkoni në faqen zyrtare të RROZHRK-se ne linkun: [Mbështetje për Organizatat e Shoqërisë Civile – Rrjeti i Organizatave për Zhvillim Rural të Kosovës](#)

Tabela e përmbajtjes

MBËSHTETJE PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE NËPËRMJET FONDIT TË AKADEMISË “NGA FERMA NË TRYEZË”	4
1.1 KONTEKSTI	4
1.2 OBJEKTIVAT E THIRRJES	4
1.3 GRANTI FINANCIAR I OFRUAR NGA AUTORITETI KONTRAKTOR	4
2. RREGULLAT PËR KËTË THIRRJE PËR PROPOZIME	6
KRITERET PËR PJESËMARRJE	6
2.1.1 KRITERI I PJESËMARRJES PËR APLIKANTËT	6
2.1.2 KRITERET PËR PROJEKTIN: PROJEKTE PËR TË CILAT MUND TË BËHEN APLIKIME	7
2.1.3 KRITERET E KOSTOVE: KOSTOT QË MUND TË PËRFSHIHEN NË BUXHET	10
2.2 SI TË APLIKOHET DHE PROCEDURAT QË DUHEN NDJEKUR	12
2.2.1 APLIKIMET.....	12
2.2.2 INFORMACIONE TË TJERA LIDHUR ME APLIKIMET	13
2.3 VLERËSIMI DHE PËRZGJEDHJA E APLIKIMEVE	13
2.4 NJOFTIMI I VENDIMIT TË AUTORITETIT KONTRAKTOR	16
2.5 E DREJTA E APELIMIT	16
KUSHTET PËR ZBATIM PAS VENDIMIT TË AUTORITETIT KONTRAKTOR PËR DHËNIEN E GRANTIT.....	17
LISTA E SHTOJCAVE	18

MBËSHTETJE PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE NËPËRMJET FONDIT TË AKADEMISË “NGA FERMA NË TRYEZË”

1.1 Konteksti

Projekti “Akademia ‘nga Ferma në Tryezë’ për Ballkanin Perëndimor të Gjellbër - E ardhmja jonë e përbashkët evropiane” zbatohet në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor (Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut, Serbi) dhe Kroaci. Projekti fokusohet në forcimin e kontributit të aktorëve të shoqërisë civile në të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor në zbatimin e procesit të integritetit dhe përafrimit në BE të këtij rajoni në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural përmes avancimit të tranzicionit të gjellbër dhe të drejtë në rajon. Projekti do ta arrijë këtë duke nxitur një mjedis më të mirë për OSHC-ve dhe rrjetet e tyre dhe aktorëve të tjerë ruralë për të kontribuar në mënyrë proaktive në trajtimin e sfidave që lidhen me ndryshimet klimatike dhe humbjet e biodiversitetit, ndërkohë që janë në gjendje të mbështesin konsultimin me pjesëmarrje dhe me drejtim nga poshtë-lart dhe dialogun konstruktiv të politikave për të përshpejtuar procesin e reformimit në përafrim me Politikën e Përbashkët Bujqësore të BE-së, në veçanti me Strategjinë e Gjellbërimit dhe përafrimin e BE-së.

Partnerët e projektit - partneriteti i Rrjeteve Kombëtare të Zhvillimit Rural (NRDN) në të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor (BB-6) dhe Kroaci dhe platforma e tyre rajonale e bashkëpunimit Rrjeti Ballkanik për Zhvillim Rural (BRDN) po udhëheqin trajtimin e çështjeve madhore të sotme lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm rural. Këto rrjete të mirëfillta të shoqërisë civile mbështesin hartimin dhe zbatimin e politikave të bujqësisë dhe zhvillimit rural në nivel kombëtar dhe rajonal në dritën e parimeve që orientojnë proceset e integritetit evropian të rajonit. Projekti i propozuar pasqyron vizionin e përbashkët të partnerëve të projektit për të kontribuar në zbatimin e procesit të integritetit dhe përafrimit në BE të sektorit bujqësor dhe zhvillimit rural në BP përmes avancimit të tranzicionit të gjellbër dhe të drejtë në të gjithë rajonin. Partnerët e projektit janë të vetëdijshëm për rolin e rëndësishëm të sektorit të shoqërisë civile (OSHC-të dhe Rrjetet e OShC-ve) në rajon në trajtimin e sfidave sociale. Megjithatë, ata kanë kapacitete të kufizuara për të kontribuar në transformimin afatgjatë social dhe ekonomik të rajonit.

Për të zgjidhur këto mangësi, projekti fokusohet në tre shtylla kryesore: ngritja e kapaciteteve të OShC-ve dhe rrjeteve të tyre për t'u bërë të mundur atyre të trajtojnë sfidat aktuale sociale në mënyrë efektive; mbështetja e zgjidhjeve lokale nëpërmjet krijimit të Fondit të Akademisë F2F dhe promovimit të agjendës së avokimit nga poshtë-lart dhe të politikave. Proceset e konsultimit me pjesëmarrje mbeten në qendër të nismave të ndërmarra nga NRND-të për të fuqizuar qasjen "nga poshtë-lart", përfshirë dhe pjesëmarrëse në zhvillimin vendor.

1.2 Objektivat e thirrjes

Objektivi i përgjithshëm i Fondit të Akademisë F2F është të forcojë kontributin e shoqërisë civile në procesin e integritetit në BE të BP-6, në veçanti përafrimi me Marrëveshjen e Gjellbër të BE-së dhe Strategjinë F2F.

Objektivat specifike të Fondit të Akademisë F2F janë të prezantojë zgjidhje novatore, të gjelbra dhe gjithëpërfshirëse për sisteme të qëndrueshme ushqimore dhe mjete jetese dhe promovimin e mëtejshëm të tyre për të zgjidhur sfidat që lidhen me ndryshimet klimatike dhe humbjet e biodiversitetit. Arritjet e Fondit të Akademisë F2F do të jenë veprimet në shkallë të vogël, të promovuara nga organizatat e shoqërisë civile, duke u fokusuar në zgjidhje novatore, të gjelbra dhe gjithëpërfshirëse për sisteme të qëndrueshme ushqimore dhe mjete jetese. Për më tepër, Fondi i Akademisë F2F do të mbështesë NRDN-të në secilin nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor dhe BRDN në përmirësimin e koalicionit dhe ngritjen e kapaciteteve për një ndikim më të madh të OSHC-ve në bujqësi dhe proceset e reformimit rural.

1.3 Granti financiar i ofruar nga autoriteti kontraktues

Shuma e përgjithshme e përcaktuar për nën-grantet nga Fondi i Akademisë ‘Nga ferma në tryezë’ e vënë në dispozicion për këtë thirrje për propozime është 240,000 EUR ose 40,000 EUR për çdo vend nga partneri përkatës i projektit në secilin nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor

Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën të mos i akordojë të gjitha fondet në dispozicion.

Ndarja e fondeve sipas linjës së fondit

Farm to Fork Academy Fund

Linja e fondit të Akademisë F2F	Buxheti në EUR	Buxheti për secilin vend në EUR
<u>Linja 1:</u> Grantet do të jepen për projektet e zbatuara nga grupet lokale të veprimit (GLV)	120,000	20,000
<u>Linja 2:</u> Grantet do të jepen për projektet e zbatuara nga organizatat me anëtarësi (Organizatat e Shoqërisë Civile në terren)	120,000	20,000

Nëse fondi i përcaktuar për një linjë të caktuar fondi nuk mund të përdoret për shkak të cilësisë së pamjaftueshme ose numrit të ulët propozimeve të dorëzuara, autoriteti kontraktor rezervon të drejtën t'i riallokojë fondet e mbetura në linjën tjetër të fondit.

Nëse fondi i përcaktuar për një linjë të caktuar fondi nuk mund të përdoret për shkak të statusit aktual ligjor dhe situatës specifike të grupeve vendore të veprimit dhe/ose OSHC-ve, organizata partnere vendos t'i riallokojë fondet në linjën tjetër të fondit.

Shumat e granteve

Çdo grant për të cilin aplikohet në këtë thirrje për propozime në të dy linjat e fondit duhet të jetë mes shumës minimale dhe asaj maksimale, si më poshtë:

- Shuma minimale e grantit: 3,000 euro;
- Shuma maksimale e grantit: 5,000 euro;

Shuma e akorduar për nën-grantet mbulon 100% të kostove të pranueshme të nismave të përfituesve të nën-granteve.

Projekti duhet të realizohet në një nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor.

2. RREGULLAT PËR KËTË THIRRJE PËR PROPOZIME

Në këto udhëzime përcaktohen rregullat për dorëzimin, përzgjedhjen dhe zbatimin e projekteve të financuara nga kjo thirrje, në përputhje me udhëzuesin praktik, i cili gjendet në internet në këtë adresë: <https://wikis.ec.europa.eu/display/ExactExternalWiki/ePRAG>.

KRITERET PËR PJESËMARRJE

Ka tre kriteret pjesëmarrjeje që lidhen me:

Aktorët (2.1.):

- “aplikanti”, d.m.th., enti që dorëzon formularin e aplikimit.

Projektet (2.2):

- projektet për të cilin mund të akordohet granti.

Kostot (2.3):

- Llojet e kostove që mund të merren parasysh në përcaktimin e shumës së grantit.

2.1.1 Kriteri i pjesëmarrjes për aplikantët

Aktorët:

Për të pasur të drejtë të konkurrojë për grant, aplikanti duhet:

- Të jetë subjekt juridik **dhe**
- Të jetë jo-fitimprurës **dhe**
- Të jetë organizatë e shoqërisë civile¹ (OSHC) ose rrjet përfaqësues i OSHC-ve² që punojnë në fushat tematike që mbulon kjo thirrje për propozime dhe të jetë e krijuar në një nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, d.m.th.: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia/
- Të jetë drejtpërsëdrejti përgjegjës për përgatitjen dhe menaxhimin e projektit, duke mos vepruar si ndërmjetës **dhe**
- Të ketë qenë i regjistruar për të paktën gjashtë (6) muaj për Linjën 1 të Fondit, dhe njëzet e katër (24) muaj për Linjën 2 të Fondit para afatit të fundit për dorëzimin e projekt propozimeve;
- Të ketë përvojë të paktën gjashtëmujore në funksionimin e Grupit Lokal të Veprimit (GLV) dhe dy vjet përvojë si një organizatë me anëtarësi, sipas Linjës së Fondit, sipas së cilës dorëzohet aplikimi me fokus kryesor në një nga fushat e mëposhtme:
 - Zhvillimi bujqësor dhe rural
 - Zhvillimi i qëndrueshëm social dhe ekonomik

¹ Siç përcaktohet në Programin Tematik të NDICI për Organizatat e Shoqërisë Civile - Programi Tregues Shumëvjeçar 2021-2027 “Shoqëria civile është shumë heterogjene dhe përfshin një gamë të gjerë aktorësh dhe synimesh. BE shprehet se organizatat e shoqërisë civile përfaqësojnë një gamë të gjerë aktorësh me role dhe mandate të shumta, ku përfshihen të gjitha strukturat jo-shtetërore, jofitimprurëse, të pavarura dhe paqësore, përmes të cilave njerëzit organizohen për të realizuar objektiva dhe ideale të përbashkët”, qofshin ato politike, kulturore, fetare, mjedisore, sociale ose ekonomike apo të lidhura me shëndetin [...]” Ato përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në: organizata joqeveritare, organizata që përfaqësojnë popujt indigjenë, organizata të grave dhe të rinjve, organizatat e diasporës, organizatat e emigrantëve, shoqatat e bizneseve dhe grupet e qytetarëve, kooperativat, shoqatat e punëdhënësve dhe sindikatat (partnerët socialë), organizatat që përfaqësojnë interesat ekonomike dhe sociale, organizatat që punojnë për luftën kundër korrupsionit, organizata për qeverisjen e mirë dhe të drejtat civile, dhe organizatat që luftojnë diskriminimin, organizatat lokale (përfshirë rrjetet) të angazhuara në bashkëpunimin dhe integrimin e decentralizuar rajonal, organizatat e konsumatorëve, organizatat mjedisore, mësimore, kulturore, kërkimore dhe shkencore, universitetet, kishat dhe shoqatat dhe komunitetet fetare, organizatat filozofike dhe studimore, organizatat joprofesionale, duke përfshirë çdo shoqatë të pavarur politike dhe jofitimprurëse të themeluar dhe fondacione politike të pavarura.

² Rrjet i regjistruar si person juridik duhet të paraqesë një aplikim nën emrin e rrjetit.

Farm to Fork Academy Fund

- Ekologjia dhe mbrojtja e mjedisit
- Mbështetje për grupet vulnerabël, të rinjtë dhe gratë në zonat rurale, fermerët e vegjël, grupet e prodhuesve, etj.

Thirrja i drejtohet:

Linja 1 e Fondit të Akademisë F2F: Linja e fondit është e dedikuar ekskluzivisht për grupet lokale të veprimit (glv) të cilat janë të regjistruara si organizata të shoqërisë civile (OSHC) dhe të cilat sipas statutit të tyre funksionojnë në përputhje me parimet LEADER të BE-së.

Të gjitha organizatat që aplikojnë duhet të dëshmojnë një përvojë të paktën gjashtëmujore në zbatimin e projekteve të ngjashme ose të njëjta me prioritetet e kësaj thirrjeje.

Linja 2 e Fondit të Akademisë F2F: OSHC vendore, organizatat me anëtarësi, përfshirë këtu shoqatat e fermerëve, federatat, kooperativat, unionet, rrjetet, grupet e grave prodhuese, dhe lloje të tjera të ngjashme organizatash që janë aktive në bujqësi, zhvillimin rural, peshkim, pylltari, etj.

Të gjitha organizatat që aplikojnë duhet të dëshmojnë një përvojë të paktën dyvjeçare në zbatimin e projekteve të ngjashme ose të njëjta me prioritetet e kësaj thirrjeje.

Aplikim i përbashkët:

aplikanti duhet të veprojë i vetëm. Nuk lejohet të marrin pjesë bashkë-aplikantë /ente të asociuara/ për këtë projekt.

2.1.2 Kriteret për projektin: projekte për të cilat mund të bëhen aplikime

Përkufizimi:

Projekti përbëhet nga një sërë aktiviteteve.

Kohëzgjatja:

Kohëzgjatja e planifikuar e një projekti nuk mund të jetë më pak se 6 muaj dhe as më shumë se 9 muaj.

Sektorët ose tematikat:

Projekte që trajtojnë sfidat e prodhimit të qëndrueshëm të ushqimit dhe ndryshimet klimatike, duke mbështetur zbatimin e strategjisë F2F dhe Marrëveshjes së Gjellbër në nivel vendor në të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë por pa u kufizuar me promovimin e:

1. Bujqësisë së qëndrueshme dhe praktikave bujqësore, zhvillimin rural dhe prodhimin e ushqimit
2. Mbrojtja e mjedisit dhe ruajtja e biodiversitetit
3. Zbutja e ndryshimeve klimatike dhe përshtatja.

Vendi:

Projektet duhet të zhvillohen në një nga vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor: Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut dhe Serbi.

Për të dy linjat e fondeve të Fondit të Akademisë F2F, projektet duhet të realizohen në zonat rurale siç përcaktohet nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të vendit përkatës.

Lutemi referojuni adresave përkatëse më poshtë për listën e zonave rurale për secilin nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor:

- Shqipëri: [Aneks-7-Lista-e-Njërive-të-Qeverisjes-Vendore-dhe-Lista-e-Zonave-Rurale.docx](#)
- Bosnje dhe Hercegovinë: Të gjitha bashkitë me një dendësi popullore nën 100 banorë/km² konsiderohen si rurale.
- Kosovë: [Lista e zonave rurale në Kosovë](#)

Farm to Fork Academy Fund

- Mali i Zi: * *Duke pasur parasysh të gjithë sipërfaqen e Malit të Zi, e cila arrin në 13,812 km², dhe bazuar në metodologjinë e OECD (Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik), bashkitë në Mal të Zi klasifikohen si më poshtë: zonat kryesisht rurale dhe zonat rurale të ndërmjetme. Prandaj, i gjithë territori i Malit të Zi ka të drejtë të aplikojë.*
- Maqedonia e Veriut: [Lista e zonave rurale në Maqedoninë e Veriut](#)
- Serbia: Lista zonave rurale në Serbi

Lloji i projektit

Objektivat e projektit duhet të jenë në përputhje me prioritetet e identifikuara nga Strategjia Kombëtare përkatëse e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit (2021-2027) të çdo vendi përkatës të BP-6 (Shqipëri³, Kosovë⁴, Bosnje dhe Hercegovinë⁵, Mali i Zi⁶, Maqedonia e Veriut⁷ dhe Serbi⁸) në lidhje me masat mbështetëse për zhvillimin e qëndrueshëm bujqësor dhe rural, mbrojtjen e klimës dhe biodiversitetit, fermerët e rinj, të rinjtë dhe gratë rurale.

Të gjitha nismat e mbështetura nga Fondi i Akademisë F2F **duhet të përfshijnë të paktën një projekt përhapjeje për të rritur ndërgjegjësimin dhe edukimin e komuniteteve vendore lidhur me ndikimin e tij në zhvillimin e qëndrueshëm dhe jetesën.**

Llojet e aktiviteteve:

Projekti duhet të përfshijë një sërë aktiviteteve që synojnë arritjen e objektivave të tij dhe maksimizimin e ndikimit të tij. Projekti duhet të përfshijë aktivitete për ngritjen e kapaciteteve dhe ato edukative, fushatat ndërgjegjëse, ngjarjet e rrjetëzimit dhe nismat e avokimit, testimin e praktikave dhe teknologjive të reja etj., të cilat të gjitha shërbejnë për të mobilizuar aktorët kryesorë dhe për të provokuar një ndryshim pozitiv në komunitetet e tyre:

Nuk do të pranohen projektet e mëposhtme:

- projektet që kanë të bëjnë vetëm ose kryesisht me sponsorizime individuale për pjesëmarrje në seminare, seminare, konferenca dhe kongrese;
- projektet që kanë të bëjnë vetëm ose kryesisht me bursa individuale për studime ose kurse trajnimi;
- projekte që kanë të bëjnë vetëm ose kryesisht me konferenca “njëherëshe” dhe ngjarje të ngjashme;
- projektet që kanë të bëjnë vetëm ose kryesisht me kërkime akademike dhe/ose studime fizibiliteti;
- projektet që kanë të bëjnë vetëm ose kryesisht me investime në infrastrukturë dhe/ose me prokurim të pajisjeve;
- projekte të lidhura me parti politike ose të natyrës politike/partiake ose fetare;
- projektet që janë në kuadër të veprimtarive të përgjithshme të institucioneve kompetente shtetërore ose të shërbimeve të administratës shtetërore, përfshirë qeverisjen vendore;
- projekte në lidhje me: industrinë e duhanit (kodi CAEN 16), prodhimin e pijeve alkoolike të distiluara (kodi CAEN 1591), armët dhe municionet (kodi CAEN 296);
- Investimet kapitale.

Llojet e aktiviteteve që **janë të pranueshme** dhe që mund të financohen në kuadër të kësaj thirrjeje janë (lista nuk është shtruese):

³ <https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2023/03/Vendim-2022-06-29-460-1.pdf>

⁴ [STRATEGJIA 20222028 FINAL ALB Web Noprint final PDF.pdf](#)

⁵ https://parlamentfbih.gov.ba/v2/userfiles/file/Materijali%20u%20proceduri_2022/BOS-Strategija%20PRR%20FBiH%20-%202027%2007%202022-%20nakon%20Ex-ante.pdf

⁶ <https://www.mzsv.gov.mk/CMS/Upload/strateski%20dokumenti/%D0%9D%D0%A1%D0%97%D0%A0%D0%A0%202021-2027.pdf>

⁷ <https://www.mzsv.gov.mk/CMS/Upload/strateski%20dokumenti/%D0%9D%D0%A1%D0%97%D0%A0%D0%A0%202021-2027.pdf>

⁸ [https://vladars.rs/sr-SP-](https://vladars.rs/sr-SP-Cyrl/Vlada/Ministarstva/mps/%D0%BC%D0%B8%D0%BD%D0%B8%D1%81%D1%82%D0%B0%D1%80%D1%81%D1%82%D0%B2%D0%BE/Documents/strategija%202021%202027.pdf)

[Cyrl/Vlada/Ministarstva/mps/%D0%BC%D0%B8%D0%BD%D0%B8%D1%81%D1%82%D0%B0%D1%80%D1%81%D1%82%D0%B2%D0%BE/Documents/strategija%202021%202027.pdf](https://vladars.rs/sr-SP-Cyrl/Vlada/Ministarstva/mps/%D0%BC%D0%B8%D0%BD%D0%B8%D1%81%D1%82%D0%B0%D1%80%D1%81%D1%82%D0%B2%D0%BE/Documents/strategija%202021%202027.pdf)

Farm to Fork Academy Fund

1. Organizimi i sesioneve trajnuese për fermerët vendas, prodhuesit dhe drejtuesit e komunitetit për të rritur aftësitë në lidhje me praktikën e qëndrueshme bujqësore, zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe ruajtjen ekologjike;
2. Krijimi i fushatave të fokusuara në edukimin e komuniteteve lokale rreth ndryshimeve klimatike, teknikave të qëndrueshme bujqësore dhe Marrëveshjes së Gjellbër Evropiane;
3. Organizimi i takimeve ndërmjet organizatave të ndryshme lokale, fermerëve dhe aktorëve kryesorë për të ndërtuar rrjete më të forta, për të shkëmbyer njohuri dhe për të bashkëpunuar për çështje të përbashkëta;
4. Organizimi i ngjarjeve që bashkojnë politikëbërësit, ekspertët dhe drejtuesit e komunitetit për të diskutuar lidhur me sfidat dhe mundësitë në zhvillimin rural, bujqësinë e qëndrueshme dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike;
5. Angazhimi në përpjekjet e avokimit që synojnë ndikimin në politikat lokale dhe kombëtare në favor të bujqësisë së qëndrueshme, strategjive të përshtatjes klimatike dhe programeve të zhvillimit rural;
6. Hartimi i planeve të veprimit me komunitetet lokale për të zbatuar praktika bujqësore rezistente ndaj klimës ose strategji të tjera mjedisore për të reduktuar ndikimin e ndryshimeve klimatike;
7. Organizimi i programeve dhe seminareve që synojnë veçanërisht të rinjtë dhe gratë fermere për të inkurajuar pjesëmarrjen e tyre aktive në bujqësi të qëndrueshme dhe në proceset vendimmarrëse;
8. Ngritja e fermave demonstruese ose projekteve pilot për të shfaqur teknikat e bujqësisë miqësore me mjedisin dhe të qëndrueshme si bujqësia organike, agropylltaria dhe metodat e ruajtjes së ujit;
9. Organizimi i shkëmbimeve ndërmjet fermerëve lokalë ose drejtuesve të komunitetit nga rajone të ndryshme për të mësuar nga përvojat e njëri-tjetrit dhe për të marrë praktikën më të mira për bujqësi të qëndrueshme dhe zhvillim rural;
10. Organizimi i ngjarjeve apo ekspozitave lokale për të shfaqur dhe evidentuar ndikimin e ndryshimit të klimës në komunitetet rurale dhe për të prezantuar zgjidhje, teknologji dhe qasje që mund të ndihmojnë në zbutjen e efekteve të tij;
11. Organizimi i seancave edukative lidhur me agroekologjinë, një qasje bujqësore që integron parimet ekologjike me praktikën bujqësore, për të promovuar biodiversitetin, shëndetin e tokës dhe ruajtjen e ujit në zonat rurale;
12. Ofrimi për fermerëve i njohurive dhe mjeteve për praktikën bujqësore të zgjuara për klimën, të cilat përfshijnë diversifikimin e të korrave, sistemet e ujitjes me kursim uji dhe kulturat rezistente ndaj thatësirës për t'iu përshtatur kushteve klimatike në ndryshim;
13. Krijimi i programeve që shqyrtojnë mundësitë alternative të jetesës për komunitetet rurale, të tilla si bletaria, eko-turizmi ose zëjtaria, për të reduktuar varësinë nga bujqësia tradicionale duke nxitur qëndrueshmërinë mjedisore;
14. Mbështetja për krijimin dhe menaxhimin e tregjeve lokale të fermerëve ku prodhuesit e vegjël mund të shesin produktet e tyre drejtpërdrejt te konsumatorët, duke promovuar sistemet ushqimore lokale dhe duke ofruar mundësi më të mira të ardhurash për fermerët;
15. Organizimi i aktiviteteve që synojnë përmirësimin e pjellorisë së tokës nëpërmjet praktikave të tilla si kompostimi, mbulimi i kulturave bujqësore dhe punimi i reduktuar për të rritur produktivitetin dhe qëndrueshmërinë bujqësore për një afat të gjatë kohor;
16. Zbatimi i projekteve të agropylltarisë që integrojnë pemët dhe shkurret në sistemet bujqësore, duke ofruar përfitime të shumëfishta si stabilizimi i tokës, ruajtja e biodiversitetit dhe rritja e të ardhurave nëpërmjet shitjes së produkteve jodrusore;

Farm to Fork Academy Fund

17. Organizimi i seminareve dhe demonstrimeve mbi teknikat e kursimit të ujit si ujitja me spërkatje, vjelja (grumbullimi) i ujit të shiut dhe menaxhimi i pellgut ujëmbledhës për të ndihmuar fermerët të reduktojnë përdorimin e ujit ndërkohë që ruajnë produktivitetin;
18. Lehtësimi i programeve që nxisin kursimin dhe shkëmbimin e farërave vendase, promovimin e përdorimit të varieteteve vendase dhe rritjen e sigurisë ushqimore duke ruajtur biodiversitetin;
19. Krijimi i programeve që lidhin fermerët vendas drejtpërdrejt me restorantet, shkollat dhe institucione të tjera për të promovuar konsumin e ushqimit vendas, të prodhuar në mënyrë të qëndrueshme, duke mbështetur kështu ekonominë lokale dhe duke reduktuar gjurmën e karbonit në transportin e ushqimit;
20. Organizimi i nismave për të promovuar përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë si energjia diellore ose biogazi në komunitetet rurale, duke reduktuar varësinë nga lëndët djegëse fosile dhe duke ofruar zgjidhje të qëndrueshme të energjisë për bujqësinë dhe ndërmarrjet rurale.

Vizibiliteti

Aplikantët duhet të respektojnë dhe përmbushin objektivat dhe prioritetet dhe të garantojnë vizibilitetin e financimit të BE-së (shih 'Komunikimi dhe Vizibiliteti për projektet e jashtme të BE-së' të specifikuar dhe të publikuara nga Komisioni Evropian në https://commission.europa.eu/system/files/2022-07/communicating_and_raising_eu_visibility_-_guidance_for_external_projects_-_july_2022.pdf)).

Aplikantët duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për të publikuar faktin që këtë projekt e financon Bashkimi Evropian nëpërmjet Projektit 'Akademia nga Ferma në Tryezë'. Për aq sa është e mundur, projektet që financohen tërësisht nga Bashkimi Evropian duhet të përfshijnë aktivitete informacioni dhe komunikimi të planifikuara për të rritur ndërgjegjësimin e grupeve të synuara ose publikut në përgjithësi për qëllimet e projektit dhe mbështetjen e BE-së për projektin në shtetin në fjalë, si dhe rezultatet dhe ndikimin e kësaj mbështetjeje.

Numri i aplikimeve për aplikant:

Aplikanti **nuk mund të bëjë më shumë se një aplikim** në kuadër të kësaj thirrjeje për propozime.

Nëse nuk respektohet ky rregull, të gjitha aplikimet që shkelin këtë rregull do të refuzohen.

2.1.3 Kriteret e kostove: kostot që mund të përfshihen në buxhet

Kostot e pranueshme do të rimbursohen sipas shpenzimeve faktike të bëra, të përcaktuara në buxhet. Kategoritë e kostove të pranueshme dhe të papranueshme tregohen më poshtë. Buxheti duhet të jetë i mirëplanifikuar, i thjeshtë dhe realist, duke përdorur çmimet e tregut për llogaritjet e kostove në EUR. Do të financohen vetëm shpenzimet e listuara në buxhet. Aplikantët duhet të japin arsye të shpjegime të detajuara për kostot e projektit dhe burimet e financimit në Aneksin B. (Buxheti i Projektit).

Rekomandimet për akordimin e një nën-granti kanë kushtin e pakontestuar që kontrollet që i paraprijnë nënshkrimit të kontratës së nën grantit të mos nxjerrin në pah probleme që kërkojnë ndryshime të mëdha në buxhet (me përjashtim të gabimeve të vogla apo pasaktësive aritmetikore). Kontrollet mund të sjellin kërkesa për sqarime dhe mund ta çojnë autoritetin kontraktor të imponojë modifikime ose reduktime për të adresuar gabime ose pasaktësi të tilla. Është e pamundur të rritet granti apo përqindja e financimit si rezultat i këtyre korrigjimeve.

Prandaj, është në interesin e aplikantëve që të ofrojnë një buxhet realist dhe me kosto të vërteta.

Kriteret për kostot

Kostot e pranueshme janë kostot faktike që janë shpenzuar nga përfituesi i grantit dhe që plotëson të gjitha kriteret e mëposhtme:

- Janë bërë gjatë zbatimit të projektit

Farm to Fork Academy Fund

- Janë përcaktuar në buxhetin e përgjithshëm të projektit
- Janë të nevojshme për zbatimin e projektit që është subjekt i këtij granti
- Janë të identifikueshme dhe të verifikueshme, në veçanti, duke u regjistruar në regjistrat kontabël të përfituesit dhe të përcaktuara sipas standardeve të kontabilitetit që janë në fuqi në shtetin ku është vendosur përfituesi dhe sipas praktikave të zakonshme të përfituesit për kontabilitetin e kostove;
- Janë në përputhje me kërkesat e legjislacionit tatimor dhe social në fuqi
- Janë të arsyeshme, të justifikuar dhe që përputhen me parimin e menaxhimit të shëndoshë financiar, veçanërisht për sa i përket ekonomisë dhe efikasitetit.

Kostot e drejtpërdrejta të pranueshme

Do të pranohen vetëm kostot e mëposhtme të drejtpërdrejta të përfituesve:

- Kostot e burimeve njerëzore: Kostoja e personelit e planifikuar për projektin, që korrespondon me pagat aktuale bruto, përfshirë pagesat e sigurimeve shoqërore dhe kosto të tjera të lidhura me pagat. Pagat nuk duhet të kalojnë 25% të buxhetit total të projektit;
- Kostot e udhëtimeve dhe dietave: Për personelin dhe personat e tjerë që marrin pjesë në projekt, me kusht që të mos i tejkalojnë ato që zakonisht përballohen nga përfituesi i grantit sipas rregullave dhe rregulloreve ose tarifave të tij. Rekomandohet fuqimisht që të blihen shërbimet që ofrojnë çmimet me kosto më efektive. Kostot e udhëtimit duhet të justifikohen si opsioni me koston më efektive. Udhëtimi me automjet personal do të lejohet vetëm nëse justifikohet dhe llogaritet në bazë të tarifës 0.25 EUR/km;
- Kostot e blerjeve (pajisje dhe materiale): për pajisjet (të reja apo të përdorura) dhe materiale që lidhen posaçërisht me nevojat dhe qëllimet e projektit duhet të mbështesin drejtpërdrejt ndërhyrjet konkrete në prodhimin e qëndrueshëm të ushqimit, zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe mbrojtjen e mjedisit, në përputhje me strategjinë F2F dhe Marrëveshjen e Gjelbër, dhe mund të përbëjnë deri në 40% të buxhetit total të projektit.
- Kostot e aktivitetit për të mbuluar shpenzimet për aktivitetet e planifikuara sipas projekt-propozimit
- Kostot e tjera: çdo kosto tjetër që lind drejtpërdrejt nga kërkesat që imponohen nga marrëveshja e grantit.

Kategoritë e listuara më sipër përfaqësojnë kostot e mundshme të drejtpërdrejta të pranueshme. Nëse një projekt nuk parashikon kosto të caktuara (p.sh., seminare/seminare/konferenca), këto kategori mund të lihen bosh në buxhetin e vlerësuar.

Për të qenë të pranueshëm (të pagueshëm), kostot duhet të kryhen gjatë periudhës së zbatimit të projektit, duke filluar nga hyrja në fuqi e marrëveshjes së grantit deri në mbylljen e projektit. Të gjitha kostot e drejtpërdrejta të pranueshme duhet të justifikohen me dokumente mbështetëse, të tilla si fatura, fletë e punës (timesheet) ose dëshmi të udhëtimit ose pjesëmarrjes në takime. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kërkojë çdo dokument mbështetës për të verifikuar që kostot e deklaruara si të pranueshme të jenë kryer dhe paguar.

Kostot e papranueshme

Kostot e mëposhtme nuk mund të mbulohen nga granti:

- Shpenzimet e bëra për aktivitetet e aplikantit të ndërmarra para nënshkrimit të kontratës;
- Borxhet dhe tarifat e shërbimit të borxhit (interesi);
- Pagesat për humbjet, ose detyrimet e mundshme në të ardhmen;
- Aktivitetet e aplikantit që synojnë aktivitetet fitimprurëse;
- Aktivitetet e aplikantit që janë të lidhura drejtpërdrejt me/ose mbështetëse të agjendave politike ose fetare;
- Ridhënie granti;
- Kostot e deklaruara nga përfituesi dhe të financuara përmes granteve të tjera;
- Blerja e tokës, ndërtesave dhe automjeteve, përveç rasteve kur është e nevojshme për zbatimin e drejtpërdrejtë të projektit, në të cilin rast pronësia duhet të transferohet në përputhje me nenin 7.5 të dispozitave të përgjithshme të kontratës standarde të grantit, jo më vonë se fundi i projektit;

Farm to Fork Academy Fund

- Humbjet nga këmbimi valutor;
- Kredi për palët e treta;
- TVSH që nuk mund të rikuperohet me mjete të tjera
- Bonuset dhe shpërblimet e stafit, tarifat doganore dhe të importit dhe komisione të tjera
- Gjoha, ndëshkime financiare dhe shpenzime gjyqësore
- Sponsorizimet individuale të përfituesit për pjesëmarrje në seminare, konferenca, kongrese;
- Pajisjet e zyrës si printera; kompjutera; telefona etj
- Shpenzime duhani dhe alkooli

Projekti nuk parashikon % të kostove të tërthorta (indirekte).

Në modelin e buxhetit ekziston një tabelë “Justifikimi i kostove të vlerësuara” në të cilën aplikantët duhet të parashikojnë për secilën linjë buxhetore sa vijon:

- shpjegim narrativ i secilit zë buxhetor, duke demonstruar domosdoshmërinë e kostove dhe lidhjen e tyre me projektin (p.sh. duke iu referuar aktiviteteve të projektit ose rezultateve në përshkrimin e projektit)
- arsyetimi i llogaritjes së kostove të llogaritura (lutemi vini re se llogaritja duhet të bazohet në kostot reale).

2.2 SI TË APLIKOHET DHE PROCEDURAT QË DUHEN NDJEKUR

2.2.1 Aplikimet

Propozimet e projektit duhet të dorëzohen në gjuhën lokale me një përmbledhje të aplikacionit në anglisht (Shtojca A.1), në përputhje me udhëzimet e dhëna në këto Udhëzime dhe në Formularin e Aplikimit.

Aplikimet me shkrim dore nuk do të pranohen.

Aplikantët duhet të dorëzojnë paketën e plotësuar të aplikimit që përbëhet nga:

A. Formuari i Aplikimit (përfshirë deklaratën e nënshkruar dhe vulosur nga aplikanti dhe një listë e plotësuar kontrolli)

B. Buxheti (të dy të plotësuar – buxheti dhe justifikimi)

Që duhet të dërgohet në adresën F2FAcademyFund@anrd.al deri në datën **25 Prill 2025**, ora 23:59. Vetëm aplikimet e listuara në këtë udhëzues dhe formularët e listuar në listën e kontrollit do të vlerësohen. Mos dërgoni dokumente shtesë përveç rasteve kur kërkohet në formularin e aplikimit.

Aplikantët e mundshëm mund të dërgojnë pyetje në lidhje me Fondin e Akademisë F2F dhe procesin e dorëzimit të aplikimit në të njëjtën adresë email të përmendur më sipër, jo më vonë se 21 ditë përpara afatit përfundimtar, pra deri në datën **4 Prill, 2025**. Pyetjet dhe përgjigjet me shënime të rëndësishme për aplikantët do të publikohen në adresën <https://anrd.al/ongoing/farm-to-fork-academy-for-green-western-balkans/> jo më vonë se data **14 Prill 2025**, në përputhje me rregullin për t'i publikuar ato të paktën 10 ditë përpara afatit të aplikimit. Prandaj është e këshillueshme që të konsultoheni rregullisht me faqen zyrtare në mënyrë që të informoheni për pyetjet dhe përgjigjet e publikuara.

Për të garantuar trajtim të barabartë të aplikantëve, autoriteti kontraktor nuk mund të japë një opinion paraprak për të drejtën e aplikimit nga aplikantë, një projekt ose aktivitete të caktuar.

Së bashku me paketën e aplikimit, aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme mbështetëse:

- Dokumenti i Certifikatës së Regjistrimit të organizatës për aplikantin;
- Dokumenti i Certifikatës së Numrit Fiskal të organizatës për aplikantin;
- Certifikatë mbi detyrimet tatimore të organizatës (ATK);
- Një kopje e bilancit të fundit të organizatës për aplikantin;
- Portofoli i aktiviteteve të organizatës për aplikantin dhe/ose CV-në e stafit kryesor të projektit.

Farm to Fork Academy Fund

- Të dhënat e llogarisë bankare të OSHC/GLV të lëshuara në gjashtë muajt e fundit.

Nëse dokumentet e sipërpërmendura nuk dorëzohen me paketën e aplikimit, projekt propozimi mund të refuzohet. Paketa e aplikimit dhe dokumentet mbështetëse duhet të dorëzohen me email me temën "Mbështetje për organizatat e shoqërisë civile përmes Fondit të Akademisë nga Ferma në Tryezë – Kosovë.

Aplikimet e paplota, ato të dërguara me faks apo në forma të tjera që nuk parashikohen në këto udhëzime, aplikimet e dërguara me postë ose të dorëzuara me dorë ose të dërguara përtej afatit nuk do të merren parasysh.

Aplikantët duhet të verifikojnë që aplikimi i tyre është i plotë duke përdorur listën e kontrollit në formularin e aplikimit. Aplikimet e paplota do të refuzohen.

Organizatat, projektet e të cilave do të miratohen do të marrin mentorim (këshillim me asistencë) dhe ndihmë gjatë zbatimit të projektit.

2.2.2 Informacione të tjera lidhur me aplikimet

Në secilin nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, partneri përkatës i zbatimit do të organizojë **katër seanca informuese** për këtë thirrje për propozime.

Në Kosovë, sesionet informuese do të zhvillohen si me poshtë:

Orari i Seancës Informuese			
Shteti	Vendi	Data	Ora
Kosova	Prishtina, EU House	14.03 2025	10:00 AM
	Prizreni, Youth Center	17.03.2025	11:00 AM
	Peja, Municipal Assembly Building	18.03.2025	11:00 AM
	Ferizaj, Youth Center	24.03.2025	11:00 AM

Përveç seancave informuese, në këtë thirrje për propozime është **parashikuar një paketë e posaçme orientimi për audiencat e synuara që shprehin interes për këtë mundësi financimi**. Çdo partner zbatues në vendin përkatës të Ballkanit Perëndimor do të kryejë katër takime orientuese të dedikuara online, dy ditë për secilën linjë granti. Trajnimi do të fokusohet në dhënien e sqarimeve për aplikantët e mundshëm lidhur me procedurat dhe kushtet e vendosura për skemat e nën-granteve; mbështetjen e tyre në analizimin dhe plotësimin e formularëve të aplikimit; duke i mbështetur ata në orientimin mes dy linjave të financimit që ofrohen nga ky projekt. Datat e takimeve të orientimit do të miratohen në mënyrë konsensuale gjatë çdo seance informuese, në përputhje me nevojat e aplikantëve të mundshëm.

2.3 VLERËSIMI DHE PËRZGJEDHJA E APLIKIMEVE

Aplikimet do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga ekipi i Fondit të Akademisë F2F dhe Komisioni i tij i Vlerësimit (Kv). Të gjitha aplikimet do të vlerësohen sipas hapave dhe kritereve të mëposhtme.

Nëse nga shqyrtimi i aplikimit del se projekti i propozuar nuk i plotëson kriteret e pjesëmarrjes të përcaktuara në seksionin 2.1, aplikimi do të refuzohet pikërisht për këtë fakt.

HAPI 1: HAPJA DHE VLERËSIMI E KONTROLLI ADMINISTRATIV

Gjatë hapjes dhe kontrollit administrativ do të vlerësohen si më poshtë:

- Nëse është respektuar afati. Përndryshe, aplikimi do të refuzohet automatikisht.

Farm to Fork Academy Fund

- Nëse mungon ose është i pasaktë ndonjë nga dokumentet e kërkuara për aplikim (të renditur në seksionin 2.2), aplikimi mund të refuzohet **pikërisht për këtë arsye** dhe nuk do të vazhdohet më tej me vlerësimin.
- Verifikimi i kriterit të pjesëmarrjes do të kryhet në bazë të dokumenteve mbështetëse që janë kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.
 - Deklarata e aplikantit (Shtojca 1 e Formularit të Aplikimit) do të krahasohet dhe verifikohet me dokumentet mbështetëse të ofruara nga aplikanti. Çdo dokument mbështetës që mungon ose rezulton me mospërpupthje me deklaratën e aplikantit dhe dokumenteve mbështetëse mund të çojë në refuzimin e aplikimit pikërisht për këtë arsye.
 - E drejta e aplikantëve për të marrë pjesë e aplikantëve do të verifikohet sipas kritereve të përcaktuara në seksionin 2.2.1.

HAPI 2: VLERËSIMI I APLIKIMIT

Aplikimet që e kalojnë këtë kontroll do të vlerësohen më tej për cilësinë e tyre, përfshirë buxhetin e propozuar dhe kapacitetin e aplikantëve.

Kriteret që do të përdoren për vlerësim jepen në tabelën e mëposhtme të vlerësimit. Ekzistojnë dy lloje kriteresh vlerësimi: kriteret e përzgjedhjes dhe të akordimit të grantit.

Kriteret e përzgjedhjes ndihmojnë në vlerësimin e kapacitetit financiar të aplikantit dhe përdoren për të verifikuar nëse:

- Aplikantët janë organizata me bazë anëtarësimi që veprojnë si grupe lokale të veprimit (GVV) dhe OSHC në formën e shoqatave dhe kanë burime të qëndrueshme dhe të mjaftueshme financimi për të vijuar me aktivitetin e tyre gjatë gjithë periudhës së projektit të propozuar;
- Kanë kapacitetet menaxheriale, kompetencat profesionale dhe kualifikimet e nevojshme për të realizuar me sukses projektin e propozuar.

Kriteri i akordimit ndihmon në vlerësimin e cilësisë së aplikimeve lidhur me objektivat dhe përparësitë e përcaktuara në udhëzim dhe për akordimin e granteve për projekte që maksimizojnë efektivitetin e përgjithshëm të thirrjes për propozime. Ato ndihmojnë në përzgjedhjen e aplikimeve për të cilat Komisioni i Vlerësimit mund të ketë besim se përputhen me objektivat dhe prioritetet e tij. Ato kanë të bëjnë me rëndësinë e projektit, konsistencën e tij me objektivat e thirrjes për propozime, cilësinë, ndikimin e pritshëm, qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e kostos.

Pikëzimi:

Tabela e vlerësimit ndahet në seksione dhe nënseksione. Çdo nënseksioni i caktohen pikë mes 1 dhe 5 si më poshtë: 1 = shumë i varfër; 2 = i varfër; 3 = mjaftueshëm; 4 = mirë; 5 = shumë mirë.

Tabela e vlerësimit

Seksioni	Pikët maksimale
1. Kapaciteti financiar dhe operativ	20
1.1 A ka aplikanti/stafi përvojë të mjaftueshme në menaxhimin e projekteve të ngjashme me projektin që ka propozuar?	5
1.2 A ka aplikanti/stafi ekspertizë dhe kapacitete të mjaftueshme teknike për të zbatuar projektin?	5
1.3 A ka aplikanti/stafi kapacitet të mjaftueshëm operativ dhe menaxherial? (përfshirë stafin, pajisjet, rregullat dhe procedurat administrative dhe financiare dhe aftësinë për të zbatuar projektin)?	5

Farm to Fork Academy Fund

1.4 A ka aplikanti/stafi përvojë dhe kapacitete të mjaftueshme në menaxhimin e projekteve me madhësi të krahasueshme granti?	5
2. Rëndësia dhe lidhja e projektit	25
2.1 Sa lidhje ka propozimi me objektivat dhe specifikimet e thirrjes për propozime? *	5*2
2.2 Sa i rëndësishëm (sa relevant) është propozimi me nevojat e veçanta dhe pengesat/kufizimet e zonave të synuara? A janë përcaktuar qartë nevojat e tyre dhe a i trajton siç duhet ato projekt propozimi? *	5*2
2.3 A ka projekti elementë të veçantë me vlerë të shtuar, promovimin e barazisë gjinore dhe mundësi të barabarta apo novacione dhe praktika të mira?	5
3. Efektiviteti dhe realizueshmëria e projektit	25
3.1 A janë aktivitetet e propozuara të përshtatshme, praktike dhe në përputhje me objektivat dhe rezultatet e pritshme?	5
3.2 A është i qartë dhe i realizueshëm plani i veprimit?	5
3.3 A përmban propozimi tregues dhe rezultate të matshëm dhe objektivë për projektin?	5
3.4 Paraqitja e analizës së situatës dhe prezantimi i objektivave	5
3.5 Bashkëpunimi i kënaqshëm me aktorë të tjerë të përfshirë	5
4. Qëndrueshmëria e projektit	20
4.1 A ka gjasa që projekti të ketë ndikim të qëndrueshëm te grupet e synuara? (A është ndikimi pozitiv dhe a është përshkruar dhe matur qartë ai?)	5
4.2 A ka gjasa që projekt propozimi të ketë efekte shtrirës dhe përhapjeje dhe a ofron mundësi ai për ndarjen e njohurive? A janë realiste dhe koherente aktivitetet e propozuara për qëndrueshmërinë e projektit?	5
4.3 A janë të qëndrueshme rezultatet e pritshme të projektit të propozuar? - financiarisht (si do të financohen aktivitetet pas përfundimit të financimit?) - institucionalisht (a do të lejojnë strukturat që këto aktivitete të vazhdojnë edhe pas përfundimit të projektit? A do t'i marrin përsipër aktorët vendorë vendore rezultatet e projektit (pronësia vendore)?)	5*2
5. Buxheti dhe efektiviteti i kostove i projektit	10
5.1 A janë reflektuar siç duhet aktivitetet në buxhet?	5
5.2 A është i kënaqshëm raporti mes kostove të llogaritura dhe rezultateve të pritshme?	5
Totali maksimal i pikëve	100
**këto pikë shumëzohen me dy (2) për shkak të rëndësisë së tyre.	

Nëse totali i pikëve të tabelës së vlerësimit është nën 40 pikë, atëherë aplikimi do të refuzohet.

Pas vlerësimit, do të hartohet një tabelë ku renditen aplikimet e klasifikuara sipas pikëve që kanë marrë. Do të merren fillimisht aplikimet me më shumë pikë përkohësisht derisa të arrihet buxheti i disponueshëm për këtë thirrje për propozime. Gjithashtu, sipas të njëjtave kritere do të hartohet një listë rezervë. Kjo listë do të përdoret nëse gjatë periudhës së vlefshmërisë së listës rezervë vihen në dispozicion më shumë fonde. Çdo

Farm to Fork Academy Fund

aplikim i refuzuar do të zëvendësohet nga aplikimi i renditur më poshtë sipas klasifikimit në listën rezervë dhe që është brenda buxhetit të disponueshëm për këtë thirrje për propozime.

Lista e projekteve të akorduara për grante do të publikohet në adresën <https://anrd.al/ongoing/farm-to-fork-academy-for-green-western-balkans/>.

2.4 NJOFTIMI I VENDIMIT TË AUTORITETIT KONTRAKTOR

Aplikantët do të informohen me email për vendimin e Autoritetit Kontraktues në lidhje me aplikimin e tyre.

Para nënshkrimit të kontratës, Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të negociojë me aplikantin në mënyrë që:

- Të garantojë efektivitetin e kostove të projektit
- Të sigurojë një balancim të drejtë të kostove operative dhe jo-operative
- Të reflektojë kostot reale të tregut
- Të reflektojë kostot në përputhmë me aktivitetet e propozuara.

Çështjet e negocimit nuk duhet të ndryshojnë në asnjë mënyrë thelbin e projektit të propozuar, por të jenë në përputhje me rregullat administrative/financiare/burimet njerëzore/programatike të BE-së dhe të Autoritetit Kontraktor.

Pas përfundimit të pikave të mësipërme, kontrata e akordimit të grantit do të nënshkruhet ndërmjet aplikantit përkatës dhe Autoritetit Kontraktor.

2.5 E DREJTA E APELIMIT

Aplikanti që beson se është dëmtuar nga një gabim ose parregullsi gjatë procesit të vlerësimit dhe akordimit të grantit, mund të paraqesë një ankesë.

Kërkesa e ankesës duhet të bëhet drejtpërdrejt nga aplikanti jo më vonë se shtatë ditë kalendarike nga data e publikimit të informacionit nëpërmjet një njoftimi me shkrim në adresën F2FAcademyFund@anrd.al dhe duhet të përshkruajë qartë bazën e problemit/ankesës.

Përgjigja e plotë do t'i dërgohet ankimuesit jo më vonë se 15 ditë nga data e paraqitjes së ankesës.

Në ankesë do të marrin pjesë Menaxheri i Grantit dhe Koordinatori Kombëtar përkatës, i cili do të përgatisë një raport përmbledhës për të gjitha procedurat e kryera.

Nëse ka prova të qarta për një gabim, i cili mund të ketë ndikuar në vendimin për financim, projekti do të rivlerësohet. Nëse nuk ka dëshmi të qarta për gabime të mundshme, nuk do të bëhet asnjë rivlerësim. Të gjitha ankesat trajtohen në mënyrë konfidenciale duke ruajtur të dhënat personale të çdo pale të interesuar.

Farm to Fork Academy Fund

KUSHTET PËR ZBATIM PAS VENDIMIT TË AUTORITETIT KONTRAKTOR PËR DHËNIEN E GRANTIT

Pas vendimit për akordimin e grantit, përfituesit do t'i ofrohet një kontratë e bazuar në kontratën standarde të grantit. Duke nënshkruar formularin e aplikimit, aplikantët bien dakord, nëse i jepet një grant, të pranojnë kushtet kontraktuale të kontratës standarde të grantit.

Tabelë me afatet tentative

	DATE	TIME
1. Seancat informuese	[14-24 mars, 2025]	10:00 – 12:00
2. Afati i fundit për kërkesat për sqarime që mund të jepen nga Autoriteti Kontraktor	21 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të aplikimeve 4 prill, 2025	17:00
3. Data e fundit gjatë të cilës Autoriteti Kontraktor jep sqarime	11 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të aplikimeve 14 prill, 2025	17:00
4. Afati përfundimtar për dorëzimin e aplikimeve.	25 prill, 2025	23:59
5. Informacione për aplikantët për hapjen dhe kontrollin administrativ dhe kontrollin për përmbushjen e kriterëve për pjesëmarrje (Hapi 1)	2 maj, 2025	17:00
6. Informacione për aplikantët për vlerësimin e të gjithë paketës së aplikimeve (Hapi 2)	30 maj, 2025	17:00
7. Shpallja e fituesit (Hapi 3)	04 qershor, 2025	17:00
8. Nënshkrimi i kontratës	16 qershor, 2025	17:00

Të gjitha oraret janë sipas zonës së orës së vendit të Autoritetit Kontraktues.

Kjo tabelë me afatet tentative i referohet datave provizore (përveç datave 1, 2, 3, dhe 4) dhe mund të përditësohen nga Autoriteti Kontraktues gjatë procedurës. Në raste të tilla, tabela e përditësuar do të publikohet në faqen zyrtare të ANRD.

LISTA E SHTOJCAVE
DOKUMENTET QË DUHEN PLOTËSUAR

Shtojca A: Formulari i aplikimit për grant (format në MS Word)

Shtojca A.1: Përmbledhje e projekt propozimit në gjuhën angleze

Shtojca B: Buxheti (në format MS Excel)

Shtojca C: Formulari i identifikimit ligjor

Përveç sa më sipër, aplikanti duhet të dorëzojë dokumentet mbështetëse si më poshtë:

- Dokumenti i Certifikatës së Regjistrimit të organizatës për aplikantin;
- Dokumenti i Certifikatës së Numrit Fiska të organizatës për aplikantin;
- Certifikatë mbi detyrimet tatimore të organizatës (ATK);
- Një kopje e bilancit të fundit të organizatës për aplikantin.
- Portofoli i aktiviteteve të organizatës për aplikantin dhe/ose CV-në e stafit kryesor të projektit.
- Të dhënat e llogarisë bankare të OSHC/GLV të lëshuara në gjashtë muajt e fundit.

DOKUMENTE PËR INFORMACION

Shtojca I: Dispozitat e Përgjithshme

Shtojca II: Rregullat për Akordimin e Kontratës

Shtojca III: Model Raporti Narrativ

Shtojca III.A Model Raporti Narrativ (Anglisht)

Shtojca IV: Model Raporti Financiar

Shtojca IV: Kërkesë për pagesë për kontratën e grantit